



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:004905

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05160221

Ep.nr.7/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P., ndaj debitores N. G, me adresë në fshatin K, K së P, me bazë juridike përbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores kundër Urdhrit të Përmbauesit Privat B. B, në Pejë, P.nr./I.Br.374/21, i datës 07.12.2021, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitores N. G, nga fshati K, i Komunës së P, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht, Urdhri i Përmbauesit Privat Blerim Baloku, në Pejë, P.nr./I.Br.374/21, i datës 07.12.2021, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 3546.61 Euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitores dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor, P.nr./I.Br.374/21, i datës 07.12.2021, i Përmbauesit Privat B. B, me seli në P, sa i përket shumës prej 768.10 euro.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me..... Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P., me datë 07.12.2021, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për

pagesën e konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 09.05.2013 deri me datën 11.11.2021, baza juridike borxh në vlerë prej 4314.71€.

Duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Përmbaruesi Privat përmes Urdhrit për Përmbarim P.nr./I.Br.374/21, të datës 07.12.2021, e ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitorja në afatin e lejuar ligjor, me datën 09.12.2021, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor duke theksuar se: urdhri për caktimin e përmbarimit është marrë në shkelje të dispozitave të nga neni 71 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.4 i LPP-së, ngase dokumenti i besueshëm-ekstrakti i verifikuar me numër të llogarisë DPE-24725, nuk është origjinal apo kopje e vërtetuar dhe e ngarkon debitorin në mënyrë paushalle për kinse borxhin pa e paguar në periudhën kohore 09.05.2013-11.11.2021, për shërbime në emër të konsumit të energjisë elektrike po ashtu kreditori nuk ia ka bashkangjitur as faturat e shpenzimeve mujore me çka konsideroj se dokumenti i besueshëm nuk i ka tiparet e dokumentit përmbarues dhe si i tillë nuk paraqet urdhër ekzekutiv. Sipas nenit 360 par.1 pika 1.3 dhe par.2 të LMD-së kërkesa për periudhën të cilën kreditori e ka kërkuar borxhin është parashkruar pasi i ka kaluar afati brenda të cilit mund të kërkohej përmbarimi, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit, të prishet urdhri përmbarimor dhe të përfundohet procedura përmbarimore.

Përfaqësuesi i kreditorit me datën 16.12.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar prapësimin e ushtruar nga ana e debitores si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove duke shtuar se: kreditori e ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm saktësisht ekstraktit nga librat afariste në përputhje me nenin 29 par.1.2 të LPP-së. Sa i përket çështjes së parashkrimit në të cilin është thirr pala debitore në prapsim, kreditori konsideron se ky pretendim nuk qëndron pasi që periudha për të cilën është kërkuar borxhi është precizuar në propozim me datën 06.12.2021, si borxh kumulativ jo i ndarë faturë për faturë mujore ndërsa pagesa e bërë nga debitorja me datën 16.04.2021, në vlerë prej 50.00 Euro, në emër të energjisë elektrike është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit, që shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit sipas nenit 368 të LMD-së. Pagesat e debitores janë bërë në drejtim të pagimit të obligimit të tij, duke u përshkruar si "*Pagesë e energjisë elektrike*", duke mos paguar për secilën faturë veç e veç, kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit, ngase parashkrimi i kërkesave të parapara me nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, rrjedhë për secilën faturë veç e veç, e që pagesa e kësteve në emër të borxhit e jo në emër të faturës së specifikuar do të thotë pranim i borxhit në tërësi sipas nenit 368 par 1 dhe 2 i LMD-

së, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrin përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbarim të datës 07.12.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat B. B, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.374/21, të datës 07.12.2021, në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 09.05.2013 deri me datën 11.11.2021, në shumën prej 4.314.71 Euro, për konsumin e energjisë elektrike.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbarimore është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbarim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (tutje LPP), që përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 09.05.2013 e deri më 31.12.2019, në shumë prej 3546.61 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbarim, e ka paraqitur më datën 07.12.2021 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 09.05.2013 e deri më 31.12.2019, është parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkoj përmbushjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 dhe par.3 të LMD-së që përcakton se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”*. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se *“Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.”*

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek kërkesat periodike siç është rasti konkret, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Si rrjedhojë, për borxhin e vitit 2013 afati ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2013, respektivisht më 31.12.2013, ndërsa i njëjti është parashkruar pas një viti gjegjësisht me 31.12.2014.

Parashkrimi për borxhin të vitit 2014, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2014, respektivisht me 31.12.2014, ndërsa ka arritur parashikimin me 31.12.2015.

Parashkrimi për borxhin e vitit 2015, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2015, respektivisht me 31.12.2015, ndërsa ka arritur parashkrimin me 31.12.2016.

Parashikimi për borxhin e vitit 2016, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2016, respektivisht me 31.12.2016, ndërsa ka arritur parashkrimin me 31.12.2017.

Parashikimi për borxhin e vitit 2017, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2017, respektivisht me 31.12.2017, ndërsa ka arritur parashkrimin me 31.12.2018.

Parashikimi për borxhin e vitit 2018, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2018, respektivisht me 31.12.2018, ndërsa ka arritur parashkrimin me 31.12.2019.

Parashikimi për borxhin e vitit 2019, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2019, respektivisht me 31.12.2019, ndërsa ka arritur parashkrimin me 31.12.2020.

Kurse, propozimi për përmbarim nga kreditori është paraqitur me 07.12.2021, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmbarim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç'rast, borxhi i krijuar nga 09.05.2013 e deri më 31.12.2019, në shumë prej 3546.61 euro është parashkruar.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitorja detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 768.10 euro për furnizimin me energji elektrike, për periudhën kohore nga 01.01.2020 e deri më 11.11.2021, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim të datës 07.12.2021, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2020 e deri më 11.11.2021. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit të vitit 2020 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2020 dhe borxhi i vitit 2020 do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2021, ndërsa borxhi i vitit 2021, do të arrinte parashkrimin me 31.12.2022, kurse kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datën 07.12.2021, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së. Paraqitja e propozimit e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitorja detyrohet që shumën prej 768.10 euro t’ia paguaj kreditorit.

Pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit të debitorës pasi që faturat e rregullta të energjisë elektrike të shpenzuar për periudhën që është kërkuar në prapësim i janë lënë konsumatorit, gjykata e gjen si të pabazuara duke u mbështetur në nenin 360 par.3 të LMD-së, i cili përcakton se afati i parashkrimit *“rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”*.

Për më tepër, edhe pretendimin e kreditorit se pagesa e bërë nga debitorja me datën 16.04.2021, në vlerë prej 50.00 Euro, në emër të energjisë elektrike është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit, që shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit gjykata e konsideron si të pabazuar, në mbështetje të nenit 368 të LMD-së, i cili në paragrafët 1 dhe 2, përcakton: *“1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.”*, kështu gjykata e gjen si të pabazuar pretendimin e kreditorit përderisa nuk është vërtetuar se nuk kemi pagesa të kësteve nga ana e debitorës pasi që një gjë e tillë mund të vjen në shprehje vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorës për pagesën e borxhit në këste të caktuara, ndërsa çfarëdo pagese e rregullt e bërë nga ana e

debitores nuk e nënkupton pranimin e borxhit të tërësishëm. Që të konsiderohet se debitorja e pranon borxhin e parashkruar, është situatë që e rregullon shprehimisht neni 347 par.1 i LMD-së, i cili përcakton se: *“Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi”*. Në rastin konkret, për të konsideruar se debitori ka pranuar në tërësi borxhin e parashkruar duhet që në mënyrë të vullnetshme dhe me shkrim të pranoj dhe njoh detyrimin e parashkruar, e që në rastin konkret një pranim i tillë nga ana e debitorit nuk ka ndodhur. Në këtë drejtim, pretendimi i kreditorit është tërësisht i pabazuar.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të debitores të paraqitura në prapësim se që kreditori nuk ka dëshmuar faturat në bazë të të cilave është lejuar përmbarimi me çka konsideron se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri për caktimin përmbarimit të propozuar nuk ka tipare të dokumentit përmbarues dhe si i tillë nuk paraqet titull ekzekutiv, Gjykata i vlerëson si të pabazuara për faktin se ekstrakti afarist i paraqitur nga kreditori i përmban të gjitha elementet formale të cilat kërkon ligji për lejimin e procedurës përmbarimore, duke filluar nga emri dhe mbiemri i debitores si konsumatore, adresa e saj, detyrimet e arritura dhe periudha kohore e detyrimeve.

Tutje, Gjykata thekson se për zhvillimin e procedurës përmbarimore sipas ekstraktit afarist, nuk është e nevojshme të ketë krahas ekstraktit edhe faturat për të dëshmuar detyrimet e debitorit, përderisa ekstrakti afarist është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim siç është elaboruar edhe më lartë. Për më tepër gjykata thekson se procedura përmbarimore zbatohet përmes aplikueshmerisë së parimit të rigoroz dhe formal, përmes së cilës bëhet vetëm vlerësimi i ligjshmërinë formale të urdhrin përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm dhe në këtë drejtim, gjykata nuk mund të lëshohet në shqyrtimin material të përmbajtjes së tij dhe fakteve eventuale kontestuese.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 341 par.1 dhe 2, neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:004905
Ep.nr.7/2022, me datë 05.01.2024.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.